



30. 12. 2021

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016 datë 14. 01. 2016, dhe konform nenit 29 të Rregullores së ARRU Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë qershor 2020, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifor të DT për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregulator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e N. H "Ibër Lepenc" sh. a Prishtinë (ARRU/UTSH-14/08/2022), për aktivitetet themelore të shërbimit të ujit të pa trajtuar me shumicë.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faktuale (përfshihet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të N. H "Ibër Lepenc" sh. a, në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në pajtim me nenin 30 dhe 31 të Rregullores 12/2020 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
4. N. H "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjetësve Regional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifat e Shërbimit të përcaktuara nga ARRU-ja, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose t'u dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit; www.arru-rks.org.
5. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
6. UTSH hyn në fuqi më 1 janar 2022 dhe vlen vetëm për vitin fiskal 2022 (01.01-31.12.2022).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.

Dërguar:

1 x 1 Arkivit të ARRU

1 x 1 Departamentit të Tarifave

1 x 1 Kryeshefit Ekzekutiv të N. H "Ibër Lepenc"



Hajrije Morina
Drejtoreshë e ARRU



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-14/08/2022

URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

N. H "IBËR LEPENC" SH. A PRISHTINË PËR VITIN 2022

E aplikueshme për:

KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë
KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë

Pasqyra e tarifave të shërbimit

NH "Ibër-Lepenc" Sh. A. Prishtinë për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë periudhës tarifore 01. 01 deri më 31. 12. 2022 nga procesi i tariforë për vitin 2022 sikurse janë dhënë në tabelën e më poshtme:

Tabela 1: Tarifat e ujit të pa trajtuar me shumicë

<i>Numri rendor</i>	<i>KRU-të</i>	<i>Njësia tarifore</i>	<i>Viti 2022</i>
1	Mitrovica	€/m ³	0.0201
2	Prishtina	€/m ³	0.0433

Shënim:

Për KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shipol të Mitrovicës, dhe për Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Balinc të Vushtrrisë.

Për KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shkabaj të Prishtinës, dhe për Fabrikën përpunimit të ujit në Drenas.